



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

Data 10.06.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

«Blerje karburanti» i ndare sipas loteve :

Loti 1 Naftë

Loti 2 Benzine

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Naftë 09134000-7

Benzinë 09132000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,056,335 (dymbëdhjetë milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lek, pa tvsh, për nevoja të Bashkisë Korçë për “Blerje karburanti”, i ndarë sipas loteve:

Loti 1 Naftë = 10,795,002 (dhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dy) lek, pa tvsh.

Loti 2 Benzinë = 1,261,333 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre) lek, pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” autoriteti/enti kontraktor BASHKIA KORÇË ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI I NAFTE

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit të limit të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se vlera e fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Gjithashtu vlera e kërkuar bazohet në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285 ku përcaktohet se “ Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për

tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje **Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat": 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.**

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023,2024,2025**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, Kreu V, neni 41, gërma b) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 61 të Ligjit nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklaratan sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. 5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. **Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare**, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 gërma b) të Ligjit nr. 1009/2009: "Njësitë ekonomike që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare" Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

- shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;
 - ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.
-

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit lotit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës **ose** fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara;

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Gjithashtu vlera e kërkuar bazohet në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285 ku përcaktohet se "Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

2.2.2 Ofertuesi duhet te jete i licensuar per ushrimin e aktivitetit objekt prokurimi ne perputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij. Per sa me siper duhet te paraqese: Autorizim per ushrim aktiviteti “Tregeti me pakice te lendeve djegese Karburante” ose Licence per tregetimin me pakice te karburanteve, gazit te lengshem naftes per automjet, vajrave lubrifikant per perdorim nga konsumatoret fundore” te leshuar nga Bashkia Korçë.

Ky kriter u vendos nga grupi i punes i argumentuar me procesverbalin nr.5058/1 prot. date 03.06.2026, e mbajtur prej tij si më poshtë:

Argumentimi: “Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjin 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.8450, dat 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” të ndryshuar, si dhe në V.K.M Nr.970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.
Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se jane te licencuar per ushrimin e aktivitetit objekt prokurimi.

2.2.3 Raport analize te cilesise se karburantit (nafte) te leshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial (ISHTI). Raport analiza duhet te jete leshuar brenda 6 muajve nga data e hapjes se tenderit.

Ky kriter u vendos nga grupi i punes i argumentuar me procesverbalin nr.5058/1 prot. date 03.06.2026, e mbajtur prej tij si më poshtë:

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6, gërma c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërine e produkteve me specifikimet teknike.

2.2.4 Subjekti ofertues duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise pergjate vitit te fundit.

Ky kriter u vendos nga grupi i punes i argumentuar me procesverbalin nr.5058/1 prot. date 03.06.2026, e mbajtur prej tij si më poshtë:

Argumentimi: Kriteri i mesiperm eshte percaktuar bazuar ne piken 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 7/c, dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik si dhe Ligjit 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore ne fuqi.

2.2.5 Ofertuesi te disponoje nje autobot ne pronesi ose me qera per te cilin duhet te paraqese, certifikaten e pronesisë te mjetit, lejen e qarkullimit, Siguracionin e mjetit, Certifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit dhe Certifikaten e kontrollit teknik te mjetit.

Ne rast se eshte marre me qera te paraqese kontraten e qera-marrjes, te shoqeruar me certifikaten e pronesisë te mjetit, lejen e qarkullimit te qiradhesisit, siguracionin e mjetit, Certifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit dhe Certifikaten e kontrollit teknik te mjetit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do ti kerkohen operatorit i kualifikuar i pari, para se te publikohet njoftimi i fituesit paraprak ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Ky kriter u vendos nga grupi i punes i argumentuar me procesverbalin nr.5058/1 prot. date 03.06.2026, e mbajtur prej tij si më poshtë:

Argumentimi:

Kriteri i mesiperm u vendos bazuar ne77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjin Nr.8378, datë 22.7.1998 „Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin Nr.8308, datë 18.3.1998 “Per transportet rrugore”. Udhëzimin Nr.15 datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar.

Ky kriter u vendos per arsye se sipas specifikimeve teknike furnizimi i Qendres te Kujdesit Paliativ Mery Potter do te behet me autobot, sipas kerkeses te paraqitur nga autoriteti kontraktor.

Per sa me sipër eshte e nevojshme vendosja e kriterit per disponimin e nje autoboti i cili duhet te jete i pajisuar me dokumentacionin e nevojshem per qarkullim ne menyre qe te realizohet me sukses furnizimii me naftë .”

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Ofertuesi duhet te paraqese deklarate se ofron sherbimin nepermjet kartes elektronike ne perputhje me VKM Nr 561 date 29.07.2016.

Ky kriter u vendos nga grupi i punes i argumentuar me procesverbalin nr.5058/1 prot. date 03.06.2026, e mbajtur prej tij si më poshtë:

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar ne VKM Nr.561, datë 29.7.2016 "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe ka të bëjë me mënyrën e përdorimit të karburantit të parashikuar për cdo mjet që do të furnizohet.

LOTI II BENZINE

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës të përlogaritur të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të lotit 2 Benzinë, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2 c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se 40 % të vlerës të përlogaritur te lotit qe prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe gjithshu bazohet ne nenin nenin 42 pika 3 te VKM 285 ku

percaktohet se “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës te perlllogaritur te lotit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara;
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 55 pika 4.b, nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285 ku percaktohet se “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, cka sjell një garanci të shtuar për autoritetin kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në ligj dhe është në përputhje me vlerën e lotit që prokurohet.

2.2.2 Ofertuesi duhet të jete i licencuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij. Për sa me sipër duhet të paraqese: Autorizim për ushtrim aktiviteti “Tregeti me pakice të lendeve djegëse Karburante” ose Licence për tregtimin me pakice të karburanteve, gazit të lengshëm naftes për automjet, vajrave lubrifikant për përdorim nga konsumatorët fundorë” të leshuar nga Bashkia Korçë.

Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar me procesverbalin nr.5058/1 prot. date 03.06.2026, e mbajtur prej tij si më poshtë:

Argumentimi: “Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjin 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” të ndryshuar, si dhe në V.K.M Nr.970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë të licencuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi.

2.2.3 Raport analize të cilësive të karburantit (benzinë) të leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI). Raport analiza duhet të jete leshuar brenda 6 muajve nga data e hapjes së tenderit.

Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar me procesverbalin nr.5058/1 prot. date 03.06.2026, e mbajtur prej tij si më poshtë:

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6, gërma c,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.2.4 Subjekti ofertues duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standardeve te legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise pergjate vitit te fundit.

Ky kriter u vendos nga grupi i punes i argumentuar me procesverbalin nr.5058/1 prot. date 03.06.2026, e mbajtur prej tij si më poshtë:

Argumentimi: *Kriteri i mesiperm eshte percaktuar bazuar ne piken 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 7/c, dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik si dhe Ligjit 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore ne fuqi.*

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Ofertuesi duhet te paraqese deklarate se ofron sherbimin nepermjet kartes elektronike ne perputhje me VKM Nr 561 date 29.07.2016.

Ky kriter u vendos nga grupi i punes i argumentuar me procesverbalin nr.5058/1 prot. date 03.06.2026, e mbajtur prej tij si më poshtë:

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur bazuar ne VKM Nr.561, datë 29.7.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe ka të bëjë me mënyrën e përdorimit të karburantit të parashikuar për cdo mjet që do të furnizohet.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Llogaritja e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e vecanta te pranimit (2.2.2 deri 2.2.5 dhe 2.3.1) jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me Urdhrin Nr 561 date 18.05.2026.

Specifikimet teknike të karburantit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për karburant (nafte dhe benzine) të cilat do të ndihmojë Autoritetin Kontraktor në proceset e punës për kryerjen e detyrave funksionale. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Hartimi i specifikimeve teknike është bërë në përputhje me kërkesat që përcakton VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, si dhe sipas Standardeve Shtetërore në fuqi që ato duhet të plotësojnë. Të dhënat teknike të Naftes dhe Benzines i referohen

standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar SSH EN 590 : 2025 dhe SSH EN 228:2025.

Përcaktimi i standardit SSH EN 590:2025 për furnizimin me gazoil dhe SSH EN 228:2025 për benzinen, bazohet në nevojën për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë së produktit me kërkesat teknike të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë dhe në Bashkimin Evropian. Standardi SSH EN 590:2025, i adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit si standard shqiptar, përcakton karakteristikat teknike, fiziko-kimike dhe kërkesat e performancës për karburantin diesel të përdorur në automjete dhe pajisje me motorë me ndezje me kompresion. Referimi në këtë standard siguron që produkti i furnizuar të jetë në përputhje me kërkesat e harmonizuara evropiane për cilësinë e karburantit, mbrojtjen e mjedisit, funksionimin e sigurt të motorëve dhe reduktimin e emetimeve ndotëse. Për rrjedhojë, kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin ofertat e tyre në përputhje me SSH EN 590:2025 është objektivisht e justifikuar, jodiskriminuese dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, duke garantuar furnizimin me një produkt që përmbush standardet teknike të njohura dhe të zbatueshme në nivel kombëtar dhe evropian.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës janë pjesë e dokumentave të tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT